



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

RREGULLORE MBI PUNËN E SHOQATËS SË GJYQTARËVE TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

TEB



Në bazë të nenit 29, alinea 2 të Statutit të FBK, Bordi i Shoqatës së Gjyqtarëve të Federatës së Basketbollit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 02. Prill bie këtë:

R R E G U L L O R E MBI PUNËN E SHOQATËS SË GJYQTARËVE TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore rregullohet emërtimi, shtrirja e veprimtarisë të Shoqatës së Gjyqtarëve të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: SHGJFBK), mënyra e punës, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit disiplinore të gjyqtarëve, përbërja dhe kompetencat, mënyra e vendosjes, kohëzgjatja e mandatit, përgjegjësia e Komisioneve dhe Këshillave, shfrytëzimi dhe disponimi i mjeteve.

Neni 2.

Kuvendi i Shoqatës përbëhet nga: gjyqtarët dhe vëzhguesit e listës A dhe pesë(5) gjyqtarë të listës B (me performancën më të mirë, konkurues për listën A).

Kryetarin dhe Bordin e Shoqatës e zgjedh Kuvendi i Shoqatës së Gjyqtarëve të Basketbollit në bazë të programit të prezentuar nga rradha e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kandidaturën, e në bazë të kriterëve të hartuara nga rregulloret e Shoqatës.

Kuvendi konvokohet nga kryetari ose 2/3 e përbërjes së kuvendarëve me nënshkrimet e tyre. Kuvendi mund të jetë i rregullt dhe i jashtëzakonshëm.

Neni 3.

Shoqatën e përfaqëson Kryetari.

Në mungesë të tij, Kryetari e cakton personin nga përbërja e Bordit, që do t'a zëvendësojë.

Kryetari përveç që e përfaqëson Shoqatën, kujdeset dhe përgjigjet për punën e Bordit, zbaton vendimet e Bordit, vendimet dhe konkluzionet e Bordit të Shoqatës si dhe aktet e tjera në përputhje me dispozitat e Statutit të FBK-së.

Neni 4.

Mandati i Kryetarit zgjatë katër vite me mundësi rizgjedhjeje .

Kuvendi mund të shkarkojë Kryetarin edhe para skadimit të mandatit në qoftë se vërtetohet se detyrat e besuara nuk i ka kryer me përgjegjësi ose i ka kryer në kundërshtim me aktet normative dhe Rregulloren e Shoqates.

II. QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA

Neni 5.

Bordi i Shoqatës është emëruar me qëllim të përparimit, zhvillimit dhe avancimit të gjyqtarëve, të zgjedhjes së çështjeve organizative të SHGJFBK-së, bashkëpunimit të gjyqtarëve si dhe realizimit të qëllimeve për të cilat është zgjedhur nga Kuvendi.

Anëtari i Bordit të SHGJFBK i cili pa arsye mungon në tri(3) mbledhje të thirrura nga Kryetari, nga ai kërkohet dorëheqja dhe të njëjtit i mirret e drejta e pjesëmarrjes dhe vendim marrjes. Zavendësimi i tij do të bëhet në Kuvendin e rradhës.

Neni 6.

Veprimtaria e Bordit të Shoqatës.

1. Përcakton politikën e veprimtarisë së vet, harton dhe propozon planet dhe programet e punës me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të gjyqtarëve, kontrollimit të gjyqtarëve dhe marrëdhënieve mes tyre, si dhe bashkëpunimi me Koordinatorin teknik, Sekretarin gjeneral të FBK-së, Këshillin profesional të FBK-së dhe Shoqaten e trajnerëve të basketbollit.
2. Përvetësimi i rregullave të lojës me qëllim të avancimit dhe ngritjes së cilësisë së gjykimit.
3. Kujdesi për gjykim dhe kontrollim të referimeve sipas rregullave të lojës.
4. Organizimi i seminareve dhe trajnimeve të ndryshme profesionale me qëllim të përparimit dhe aftësimin të gjyqtarëve.
5. Përgatitja dhe organizimi i provimeve për të gjitha kategoritë e gjyqtarëve, vëzhguesëve dhe kontrollorëve.
6. Harmonizimi i veprimtarive dhe kontakteve, bashkëpunimi me shoqatat e gjyqtarëve nga shtetet e tjera dhe FIBA-së.
7. Përpilimi i listave të gjyqtarëve për gjykimin e ndeshjeve të organizuara nga FBK.
8. Përpilimi i listës së kontrollorëve sipas kriterëve të FIBA.
9. Hartimi dhe aprovimi i Rregullores mbi dhënien e provimeve për gjyqtarë për të gjitha kategoritë, kategorizimi i gjyqtarëve.
10. Emërimi dhe shkarkimi i trupave punuese dhe Komisionëve.
11. Kujdesi për aftësim profesional, shëndet, mirëkuptim reciprok , aprovimi dhe zbatimin i vlerave morale në sport.
12. Përgatitja e punës së Kuvendit të punës-zgjedhor të SHGJFBK-së.
13. Dhe punë të tjera në interes të basketbollit.

Neni 7.

Puna e Bordit të SHGJFBK është publike.

Publikimi i punës së Shoqatës, realizohet me mënyrën e përcaktimit të rregulloreve të brendëshme.

- Me raportim të rregullt të anëtarëve lidhur me punën dhe veprimtarinë e Shoqatës.
- Publikimin e vendimeve të marra.

III.TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT DISCIPLINORE TË GJYQITARËVE,VËZHguesËVE DHE KONTROLLORËVE

Neni 8.

Të drejtat e gjyqtarëve,vëzhguesëve dhe kontrollorëve janë të përcaktuara me këto rregullore:

- Pjesëmarrja në tubime të organizuara nga Shoqata (seminare, trajnime, testime) etj.
- Emërimi në trupat punuese dhe komisione;
- Gjykimi i ndeshjeve;
- Kontrollimi i gjykimit;
- Aftësimi profesional si dhe pjesëmarrja e obliguar në seminare dhe trajnime, testime teorike dhe fizike;
- Zbatimi i vendimeve të Shoqatës dhe organeve të saj;
- Pagesa e anëtarësisë dhe përqindjes së përcaktuar nga Bordi i Shoqatës;
- Mbrojtja e autoritetit të anëtarëve;
- Rruajtja e pasurisë së Shoqatës;
- Kryerja e obligimeve dhe detyrave të marra nga Bordi i Shoqatës.
- Realizimi i të drejtave dhe detyrave të tjera.

Neni 9.

Kryerja e detyrës së gjyqtarit (gjykimi i ndeshjeve) pushon kur i kalon mosha pesëdhjetë(50) vjeçare, ndërsa për vëzhgues mosha gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare,konformë rregulloreve të departamentit për gjyqtarë të FIBA.

Neni 10.

Gjyqtarët, vëzhguesit dhe kontrollorët përveç detyrave dhe të drejtave kanë edhe përgjegjësi ndaj Shoqatës. Përgjegjësinë ndaj Shoqatës e vlerëson dhe vendime bie Komisioni disiplinor i Shoqatës.

Për përgjegjësin disiplinore të gjyqtarëve dhe vëzhguesëve gjatë garave zyrtare të FBK-së, vlerësimin e bënë dhe vendime merr Komisioni i garave.

Gjyqtari ,vëzhguesi dhe kontrollori,ndaj të cilit hapet procedurë disiplinore për sjellje josportive, mosrespektim të kodeksit të mirësjelljes dhe Rregullores së SHGjFBK-së,nuk mund të emërohet në organet udhëheqëse të Shoqatës, ndërsa nëse është i emëruar paraprakisht do të shkarkohet, -nëse është anëtar i Bordit nuk do të llogaritet në vendim marrje dhe do t'i kërkohet dorëheqja e tijë zyrtare.

Neni 11.

Komisioni disiplinor vendos në bazë të dispozitave të Rregullores disiplinore të Shoqatës apo të FBK-së, ndërsa Komesari i garave në bazë të Propozicioneve të Garave dhe Rregullores Disciplinore të FBK-së.

Neni 12.

Mbi vendimet e Komisionit disiplinor mund të parashtrohen ankesa. Ankesa i parashtrohet Komisionit Arbitrar të Shoqatës së Gjyqtarëve të FBK-së, vendimi i të cilit është përfundimtar.

Mbi vendimet e Komesarit të garave ankesat i parashtrohen Komisionit-Arbitrar të FBK-së, sikurse është parashikuar me Propozicionet e Garave.

Neni 13

Bordi i SHGJFBK-së përbëhet nga pesë (5) anëtarë të emëruar nga Kuvendi i SHGJFBK-së, e i cili kryen këto detyra:

- Harton programin e aktiviteteve të Shoqatës;
- Zbaton politikën e zhvillimit të anëtarësisë;
- Ndjek realizimin e Planit dhe Programit të punës, duke u kujdesur për realizimin sa më të suksesshëm të tij;
- Zgjedhë trupat punuese dhe komisionet;
- I propozon ndryshimet dhe plotësimet e Planit dhe Programit të punës;
- Propozon listën e gjyqtarëve dhe të vëzhguesëve për çdo Ligë, të cilat i aprovon Bordi i FBK-së;
- Përcakton kriteret mbi kategorizimin (rangimin) e gjyqtarëve;
- Harton dhe aprovon Rregulloren mbi dhënien e provimit për gjyqtarë dhe bënë kategorizimin e gjyqtarëve ;
- Harton dhe përgatit materialet (aktet normative) për mbajtjen e Kuvendit zgjedhor të SHGJFBK-së.
- Kryen punë dhe detyra të tjera të cilat ia beson Kuvendi i Shoqatës.

Neni 14.

Bordi i SHGJFBK, vendos në seanca për të gjitha çështjet nga fushë-veprimtaria e tij, merr vendime me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve prezent.

Mbledhjen e Bordit të Shoqatës e konvokon dhe udhëheq Kryetari.

Kryetari konvokon mbledhjen e Bordit në bazë të vlerësimit të vet .

Për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit të SHGJFK anëtarëve iu takon mëditja prej 10,00€ kurse anëtarëve të cilët udhëtojnë në qytetin ku mbahet mbledhja, u takojnë edhe 10,00€ shtesë në emër të kompenzimit të shpenzimeve të rrugës.

Neni 15.

Anëtari i Bordit të SHGJFK, ka këto të drejta dhe obligime :

- Të marrë pjesë në mbledhje të Bordit, të debatojë dhe të votojë.
- Të parashtojë propozime dhe çështje lidhur me përmbajtjen e rendit të ditës.
- Të rruaj fshehtësinë e veprimtarisë.

Neni 16

Bordi mund të formojë trupa punuese (këshilla dhe komisione) të përhershme dhe të përkohshme, vendos për kompetenca dhe emëron anëtarët e tyre.

Trupat punuese për punën e tyre i përgjigjen Bordit të SHGJFK.

Mandati i anëtarëve të trupave punuese zgjat sa edhe mandati i Bordit të SHGJFK-së. Bordi mund të shkarkojë trupat punuese ose anëtarin e tij edhe para skadimit të mandatit nëse vepron në kundërshtim me aktet normative të SHGJFK-së.

Neni 17

Trupat e përhershme të punës të SHGJFK janë:

- Sekretari i Shoqatës.
- Këshilli profesional.
- Komisioni mbi Rregullat e lojës.
- Komisioni Disiplinor.
- Komisioni Arbitrar i SHGJFK.

a) SEKRETARI I SHOQATËS

Emërohet nga Bordi i SHGJFK me mandat katër(4) vjeçar dhe nuk ka të drejt vote në vendimet e marrura nga Bordi.

Bordi mund të shkarkojë sekretarin edhe para skadimit të mandatit në qoftë se vërtetohet se detyrat e besuara nuk i ka kryer me përgjegjësi ose i ka kryer në kundërshtim me obligimet dhe përgjegjësit që i takojnë bazuar me aktet normative dhe Rregulloren e Shoqates.

- Përcjell dhe mbikëqyrë punën e komisioneve dhe këshilleve të Shoqatës.
- Mbanë procesverbalet e mbledhjeve dhe arhiven e vendimeve dhe dokumentacionit të Shoqatës.

b) KËSHILLI PROFESIONAL

Këshilli profesional përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët i emëron Bordi i SHGJFBK-së.

Veprimtaria themelore e Këshillit profesional është avancimi i punës profesionale, ngritja e cilësisë së gjyqimit dhe aftësimi i gjyqtarëve të basketbollit:

- Përcjell dhe mbikëqyrë gjykimin e gjyqtarëve dhe punën e vëzhguesëve.
- Harton programet dhe realizimin e tyre në lidhje me seminarët dhe trajnimet e gjyqtarëve dhe vëzhguesëve.
- Bënë analizat e gjykimeve të ndeshjeve dhe jep vlerësime profesionale për çdo gjyqtarë veç e veç.
- Jep vlerësime profesionale në lidhje me ankesat e gjyqtarëve për notim të dobët.
- Harton testet dhe kriteret për dhënien e provimeve për gjyqtar.
- Harton testet teorike për gjyqtarë, vëzhgues dhe kontrollor dhe organizon zbatimin e testeve.
- Harton kriteret mbi notimin e gjyqtarëve.
- Përpilon rang listën e gjyqtarëve, bënë propozimin e listave të gjyqtarëve dhe vëzhguesëve për çdo ligë veç e veç.
- Cakton kriteret e emërimit të kontrollorëve të ndeshjes, numrin e përgjithshëm të tyre të autorizuar, propozon Bordit kandidatët për emërim në cilësinë e kontrollorit të ndeshjes.
- Kryen edhe punë të tjera me të cilat e ngarkon Bordi i SHGJFBK.

c) KOMISIONI MBI RREGULLAT E LOJËS

Komisioni mbi rregullat e lojës përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët i emëron Bordi i SHGJFBK-së.

Veprimtaria themelore e Komisionit mbi Rregullat e lojës është përgatitja e materialeve mbi ndryshimet e Rregullave të lojës, dhënia e sqarimeve dhe publikimi i tyre.

Neni 18.

Bordi i SHGJFBK-së mund të formojë edhe trupa të përkohëshme të tij, sikurse janë: komisionet mbi dhënien e provimeve për gjyqtarë, vëzhguesë dhe kontrollorë. Mandati i këtyre trupave zgjatë vetëm për një aktivitet për të cilin janë emëruar. Numri i anëtarëve të trupave të përkohëshme dhe detyrat e tyre përcaktohen me vendim të veçantë nga Bordi SHGJFBK-së.

d) KOMISIONI DISCIPLINOR I SHGJFBK

Komisioni Disciplinor përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët i emëron Bordi i SHGJFBK-së.

Veprimtaria themelore e Komisionit Disciplinor është: marrja e masave disiplinore kundër çdo anëtarit të Shoqatës i cili me veprimet e veta është në kundërshtim me rregulloret, kodeksin e mirësjelljes, me veprimet e veta dëmton punën, imazhin dhe vlerësimin pozitiv për

Shoqatën.Ndaj secilit dhe secili anëtarë i shoqatës mund të iniciohet procedurë disiplinore për veprimet e tija negative.

Komisioni Disciplinor merr vendim ndaj anëtarëve të iniciuar për procedurë, konformë Rregullores disiplinore të Shoqatës, Propozicioneve të garave, Rregullores dicsiplinore të FBK-së dhe akteve tjera normative .

e) KOMISIONI ARBITRAR I SHGJFBK

Komisioni Arbitrar përbëhet nga tre(3) anëtarë dhe emërohet nga Bordi i SHGJFBK-së.

Veprimtaria themelore e Komisionit Arbitrar të SHGJFBK-së është vendimi në lidhje me ankesat në Komisionin Disciplinor të SHGJFBK. Vendimi i KA është përfundimtarë. KA merr vendim konformë Rregullores disiplinore të Shoqatës, Propozicioneve të garave, Rregullores disiplinore të FBK-së dhe akteve tjera normative.

IV. PASQYRA DHE AFARIZMI MATERIALO – FINANSIAR

Neni 19.

Pasuritë e SHGJFBK-së përbëhen nga:

- Mjetet financiare nga sponzorët.
- Pasuria e tundshme.
- Të drejtat dhe obligimet.

Neni 20.

SHGJFBK e fiton të drejtën në pasuri të tundshme dhe patundshme.

- Me pagesën e anëtarësisë.
- Me kontribute vullnetar.
- Me përqindje nga taksat e gjykimit, kontrollimit dhe burimeve të tjera.

Neni 21.

SHGJFBK, mbikëqyrë pasuritë e tundshme dhe patundshme dhe atë në tërësi.

Neni 22.

Veprimtarinë materialo – financiare e udhëheq Kryetari i SHGJFBK-së.

Kryetari i SHGJFBK-së, afarizmin materialo – financiar e realizon konformë dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve tjera përkatëse të kësaj lamije të cilat aplikohen në Kosovë.

Urdhërdhënës për realizimin e këtij afarizmi është Kryetari i SHGJFBK.

Pasuria e patundshme nuk mund të tjetërsohet pa vendimin e Bordit të SHGJFBK-së.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Dispozitat e kësaj Rregulloreje i interpreton Bordi i SHGJFBK-së.

Bordi i SHGJFBK, nëse nuk i përmbahet neneve dhe Rregullores në fuqi, atëherë konform nenit 29 të Statutit të FBK-së, do të ndërmirren masa me qëllim të zgjidhjes së çështjeve të cilat pamundësojnë punën normale dhe të suksesshme të gjyqtarëve.

Neni 24.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në mënyrën e parashikuar për nxjerrjen e saj.

Neni 25.

Me aprovimin e kësaj Rregullore pushojnë të vlejnë të gjitha aktet normative të mëhershme të miratuara nga Shoqata e Gjyqtarëve të FBK-së.

Neni 26.

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e aprovimit nga ana e Bordit i SHGJFBK-së.

Prishtinë,
Më 02. Prill 2014

K R Y E T A R I
I BORDI I SHGJFK

Lulzim Maloku

